

# NIVELI MESATAR [B2].

## Detyra me shkrim

1. Maria është një maturante nga kryeqyteti, ndërsa Albana banon pak me larg se periferia, në fshatin Vishnjë të Tiranës. Njëra ndjek mësimet në gjimnazin “Sami Frashëri”, ndërsa tjetra në shkollën e mesme të Baldushkut.

-Përhëndetje Albana. Po shoh që ditën e pushimin e kalon duke u marrë me punët e shtëpisë. Nuk bën tjetër gjë? - pyeti Maria vajzën nga fshati.

- Sa mirë do të ishte, Maria! Jeta në fshat nuk të ofron shumë mundësi për të realizuar dëshirat e moshës, ndaj kohën e lirë përgjithësisht e kaloj duke bërë punë të ndryshme në shtëpi, duke ndihmuar prindërit. - shprehet Albana.

-Vërtet?!- pyeti e habitur dhe e çuditur Maria, e cila e sheh veten krejt ndryshe, mes shanseve dhe të mirave që i ofron jeta e kryeqytetit. Përveç kohës kur jam në shkollë, fundjavave unë dal me shoqet, shkoj në kinema, teatër, dal për pazar e ndonjëherë ulem edhe në ndonjë lokal. Gjatë kohës që jam në shtëpi, përveç studimit, pjesën më të madhe të kohës e harxhoj duke kërkuar në internet informacione të ndryshme, duke lozur me lojëra, por edhe duke komunikuar me shoqet e shokët.

-Unë e kam të pamundur të kem internet në shtëpi, - i përgjigjet Albana. Internetin e përdor vetëm në shkollë për gjetjen e materialeve të ndryshme. Nuk kam faqe profili, sepse prindërit nuk ma lejojnë.

-Po celular ke? Si komunikon me shoqet?- pyeti me shumë kureshtje Maria.

-Nuk kam celular, sepse prindërit mendojnë se s’duhet ta kem për momentin për shkak të moshës. Kam shumë dëshirë ta kem, por do të pres kohën për ta pasur.” –shprehet Albana.

- Uaa, mua ma kanë blerë prindërit! Nuk më mungon asgjë. - shprehet e kënaqur Maria. Nuk e imagjinoj dot veten time në fshat. Nuk do të kisha këto mundësi argëtimi.

-Edhe mua do të më pëlqente të jetoja në qytet. Aty do të kem mundësi të realizoj dëshirat dhe ëndrrat e mia, - shprehet Albana.

-Unë jam maturante, dhe kam dëshirë të vazhdoj më tej studimet. Dua që të bëhem mjekë, ndaj dëshiroj të studio në universitet për mjekësi. Po ti Albana, çfarë dëshiron?- pyet me kureshtje Maria.

-Për mua, shkolla është e vetmja mundësi që të realizoj ëndrrat e mia. Unë mësoj shumë dhe, për çudi, edhe mua më pëlqen mjekësia. Është profesioni që ëndërroj. Dua të bëhem pediatre, të shëroj dhe të kujdesem sa më shumë për fëmijët.

-Atëherë, uroj të ritakohemi në universitet. Do të jem shumë e lumtur të jemi në të njëjtin fakultet, -thotë Maria.

Edhe mua, - thotë e lumturuar Albana, së cilës kjo ëndërr i dukej e vështirë për t’u realizuar.

*(Marrë nga Top Channel, e përshtatur)*

**1. Lexoni dialogun midis vajzave dhe plotësoni tabelën e mëposhtme. Vendosni X nëse pohimet janë të vërteta apo jo.**

	<b>E vërtetë</b>	<b>Jo e vërtetë</b>
Maria e ndan ditën e saj mes punëve të shtëpisë dhe mësimeve.		
Albana është e lumtur, sepse fati i ka buzëqeshur me tepër se Marias.		
Maria është reflektimi i kohës që ka ndryshuar brezin e ri.		
Albana është përfaqësuese e traditës që vijon të ruhet në fshat dhe në disa zona.		
Si të reja ambicioze të dyja vajzat ëndrrat i shohin të realizuara përmes shkollës.		
<b>Kanë thujse të njëjtën moshë, të njëjtat ëndrra, por bëjnë jetë të ndryshme.</b>		

**2. Në segmentin e shkëputur foljet vendosni në kohën e kryer të thjeshtë. Cilat prej tyre janë të parregullta?**

Tirana .....(shfaq) shenjat e para të ndryshimit, ajo i .....(ngjasoj) kryeqyteteve më të qeta perëndimore. Në mesnatë zhurma nuk.....(jam) më e njëjta. Por edhe qendra .....(nis) të ndiejë qetësinë. Shpesh, pubet .....(jam) në katet e para të pallateve apo rrëzë tyre dhe veç buçitjes së zhurmës, banorët e këtyre pallateve .....(ndiej) edhe tronditje si tërmet nëpër shtëpi.

“Po unë që .....(bëj) investim miliona lekë të reja për izolim akustik, - u shpreh i shqetësuar pronari i një lokali në qendër të Tiranës, pse duhet të më mbyllet bari që në mesnatë njësoj si të tjerët që nuk .....(bëj) asnjë investim?” Në fakt, ambiente të tilla si ky ata .....(gjej) shumë pak në Tiranë.

**3. Vndosni në vend të pikave njërën prej fjalëve mohuese të vendosura në anën e djathtë.**

Ylli .....pranoi lehtë propozimin tim.	<b>askush</b>
Ti .....flet konkretisht.	<b>mos</b>
Nuk shkoj në .....vend tjetër.	<b>nuk</b>
.....nuk e kuptonte.	<b>s'</b>
Mos u shqetëso .....më.	<b>jo</b>
S'janë për ty këto gjëra, ...	<b>kurrë</b>
Nuk e dëgjova.....lajmin.	<b>fare</b>

#### 4. Vendosni ndajfoljet në kllapa në shkallën krahasore:

Ai djalë fliste (rrjedhshëm) djali yt. ....

Ai djalë fliste më rrjedhshëm sesa djali yt. ....

Nuk ishte (bukur) na e kishin përshkruar.  
.....

Po të fliste (hapur) me të, do të mendonin se kishte diçka mes tyre.  
.....

Bënte (ftohtë) dje.  
.....

Këta studentë dolën (mirë) studentët e tjerë.  
.....

Rruga ishte (larg) nuk e prisja.  
.....

#### 5. Vendosni foljen në kllapa në kohën e pakryer, në vetën dhe në numrin e duhur:

1. Afër saj ishte karrigia me biskota dhe një karrige më tej një person tjetër i cili \_\_\_\_\_ (*lexoj* - veta e tretë njëjës) gazetën. 2. Ishte kënga që *ata* \_\_\_\_\_ (*dëgjoj* - veta e tretë shumës) shumë herë deri sa i zinte gjumi. 3. Ju prezantojmë ngjyrat që *ju* \_\_\_\_\_ (*kërkoj* - veta e dytë shumës) për këtë sezon veror. 4. Në mëngjes bashke me babin edhe vëllezërit e mi *ne* \_\_\_\_\_ (*ndërtoj* - veta e parë shumës) shtëpi me dru edhe gjethe pemësh. 5. Që atëherë, gjatë kohës kur po \_\_\_\_\_ (*qëndroj* - veta e tretë njëjës) në Itali *ajo* \_\_\_\_\_ (*marr* - veta e tretë njëjës) pjesë në konkurse të ndryshme muzikore. 6. \_\_\_\_\_ Më parë edhe *unë* (*punoj* - veta e parë njëjës) në fabrikë, por tani kam biznesin tim. 7. Motra ime, Diana, \_\_\_\_\_ (*jam* - veta e tretë njëjës) ende nxënëse. 8. Ata \_\_\_\_\_ (*zgjat* - veta e tretë shumës) duart dhe \_\_\_\_\_ (*marr* - veta e tretë shumës) letrat në tavolinë.

#### 6. Shpjegoni shprehjet e mëposhtme dhe formoni fjali me to.

- Është e padurueshme .....
- Ndaj mendjen .....
- Nuk dua t'ia di.....
- Vras mendjen.....
- Në plan të dytë.....
- Tifoz i çmendur.....
- Më ha merakun.....
- Nuk e duroj dot.....
- Marr malet.....

#### 7. Shkruani një tekst me temën "Sa do të dëshiroja" (me rreth 300 fjalë)